



UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NE RAJON

KËRKESË PER OFERTË

“Për kontraktimin e një Montazhiere për të realizuar videot përfundimtare përmbledhëse të projektit ‘Forumi Ekonomik Rajonal dhe Zhvillimi i turizmit në qytetet Shqiptare’ të datës 10.06.2021 dhe mbledhjes të datës 11.06.2021 organizuar nga UBSHR”

UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NË RAJON, në zbatim të fazës së dytë të projektit të Turizmit Rajonal, kërkon të rekrutojë 1 (një) montazhiere profesionistë. Në date 10.06.2021, UBSHR do të organizojë një pritje zyrtare me te ftuar nga Rajoni, ku do hapet sezoni turistik në të gjitha qytetet anëtare. Në datën 11.06.2021 do të organizohet Mbledhja me Kryetarët e Bashkive/komunave.

Detyrat

1. Të jetë në gjendje të sigurojë material të mjaftueshëm dhe të nevojshëm për realizimin e videove cilësore.
2. Të bashkëpunojë me stafin e UBSHR për të përzgjedhur momentet kryesore nga aktivitetet.
3. Të sigurojë materialin e videove përmbledhëse brenda afateve të përcaktuara nga UBSHR.

Periudha e zbatimit të detyrave

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë deri më datë 11.06.2021.

Kriteret për përzgjedhjen

1. Eksperienca në treg dhe mjetet profesionale të përdorura
2. Kostoja më e ulët e shërbimit

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

1. Jetëshkrim/CV;
2. Kopje ID/Pasaportë.
3. Oferta financiare

Afati kohor për dorëzimin e ofertave: 25.05.2021 ora 11:00.

Cdo person i interesuar mund të dërgojë dokumentat mbi këtë procedurë përmes komunikimit elektronik në adresën email ubshr@tirana.al, ose duke u paraqitur pranë zyrave të Unionit në adresën *Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati 2, Zyra 18*.
Për çdo pyetje ose sqarim mund të na shkruani në e-mail: ubshr@tirana.al.

DREJTORI EKZEKUTIV

Andriola Kambo

